



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:120548
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06342822

CA.nr.748/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Nora Bllaca Dula anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.B nga P..., të cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.H nga P..., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1585/2023, të datës 20.10.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë **14.10.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1585/2023, i datës 20.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1585/2023, të datës 20.10.2024 ka vendosur si në vijim: *“I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K.B nga P.... II.DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësit K.B, t’ia paguajë kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2022 dhe atë për periudhën kohore prej 01.01.2022 - 18.11.2022 për 179 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro për një ditë pune, gjithsej vlerën e përgjithshme prej 358.00 € (treqind e pesëdhjetë e tetë) euro, me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë (30.05.2023) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm. III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 124 €*

(njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe ta hedh poshtë padinë e paditëses apo të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ose i njëjti të prishet dhe çështjen t’ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e autorizuara e paditësit, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 25.05.2023, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me arsyet sikurse në padi, duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë *(pa shqyrtim kryesor të çështjes)* aktgjykimin e atakuar C.nr.1585/2023, të datës 20.10.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara në këtë çështje nuk është kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në ShFMU “L.D”, në P.... Gjykata e shkallës së parë përmes vërtetimit me numër Prot.nr.680-54/23, e datës 24.01.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësi, në peridhën e tërësishme të vitit 2022 ka prezentuar në punë gjithsej 210 ditë punë, ndërsa nga data 01.01.2022 deri me datë 18.11.2022 ka prezentuar në punë gjithsej 179 ditë pune. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe përcaktimit të lartësisë për shujtën ditore në shumën prej 2 € në ditë është bazuar në kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 par1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449, dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe tarifën e Odës së Avokatëve të

Kosovës. Ndërsa lidhur me vendosjen pa shqyrtim kryesor të çështjes, është bazuar në nenin 398 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadsisë së paditësit dhe nuk ka bërë tejkalim të kërkesëpadsisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditësi për vitin 2022 konkretisht për periudhën kohore prej 01.01.2022 – 18.11.2022, ka qenë në vendin e punës. Po ashtu nuk është kontestuese se paditësi për këtë periudhë kohore ka gjithsej 179 ditë pune, e për të cilën periudhë kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit - shujtës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”. Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: “Të punësuarve, (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes

restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASh, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023“.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Gjykata e Apelit, po ashtu e ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë pa i kaluar procedurat administrative, sepse nuk ushtron ankesë në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren dhe nuk i vazhdon procedurat në Inspektoratin e Punës, siç parashihet në nenin 82 të Ligjit të Punës 03/L-212 dhe gjeti se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësja brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, dhe kjo asesi nuk nënkupton se paditësja nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura ashtu siç pretendon e paditura, përkundrazi, e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëseve në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të papranueshme pretendimet ankimore të paditurës, se kompensimi i kërkuar nga paditësi nuk është paraparë me Ligjin e Punës dhe se nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, ngase i njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, andaj e paditura nuk lirohet nga obligimi për pagesën e shumave të gjykuara, sepse kontratat e nënshkruara në mes palëve kanë bazë ligjore në LMD-në, dispozitat përkatës të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, si dhe konform nenit 8 par.1 të LMD-së, ku shprehimisht thuhet “*Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit*”.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimin ankimor të paditurës për çështjen e detyrimit të saj për të kompensuar paditësin, mirëpo ka ardhur në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar, për faktin se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se paditësit i ka takuar kompensimi i vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.748/2024 datë 14.10.2024

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka